

**❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE**

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektsh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

**❖ TITULLI I POZICIONIT TË PUNËS**

Teknik Ndertimi

**❖ DETYRAT KRYESORE**

- Shqyrton projektet e zbatimit, preventivin dhe specifikimet teknike të objektit që do të ndërtohet dhe ben verejtjet perkatese kur konstaton mangesi dhe parregullesi;
- Zbaton plan organizimin e punimeve, harton planet ditore, javore dhe mujore dhe paraqet tek Inxhinieri Zbatimit / Drejtuesi I Kantierit për diskutim apo miratim;
- Mban pergjegjesi per zbatimin e punimeve ne perputhje me projektet e zbatimit, preventivin, specifikimet teknike dhe standartet;
- Merr pjese ne te gjitha matjet qe kryhen per volumet dhe mban proces verbale perkatese;
- Zbaton grafikun e punimeve ne perputhje me afatet e percaktuara ne kontratat e zbatimit te punimeve;
- Ben ndjekjen dhe monitorimin e punes sipas nenkontraktoreve, grupeve te punes apo individeve qe punojne ne objekt;
- Ndjek dhe kerkon zbatimin e disiplines ne pune;
- Jep sqarime te vazhdueshme mbi organizimin e punes dhe zbatimin e projektit dhe kushteve teknike tek Inxhinieri i Zbatimit & Drejtuesi I Kantierit;
- Ndjek zbatimin e kontratave te siper marrjes per punimet qe kryhen nga Nenkontraktore ne objekt;
- Ndjek dhe ploteson cdo dite Liste prezencen e punonjesve ne kantier;
- Ploteson cdo dite ditarin e punimeve per punimet qe ndjek dhe Librin e kantierit dhe ja paraqet eprorit per miratim;
- Harton ne menyre te vazhdueshme librezet e masave per punimet qe kryhen;
- Ploteson ne vazhdimesi dokumentacionin tekniko-ligjor gjate fazave te ndertimit deri ne perfundim te objektit;
- Evidenton nevojat per ndryshime ne projektet e zbatimit dhe preventivin e objektit;
- Ndjek dhe mban pergjegjesi per normativat e harxhimit te materialeve qe vendosen ne veper;
- Kontrollon dhe verifikon qe te gjitha materialet qe vihen ne objekt dhe mban rekorde te rregullta te tyre;
- Merr pjese ne kryerjen e analizave dhe provave te materialeve ne laboratore dhe atyre qe behen ne kantier;
- Propozon zgjidhjen e problemeve teknike dhe I diskuton me eproret perkates ne kantier.

**❖ KRITERET KRYESORE**

**Edukimi:** Diplome si Teknik ndertimi.

**Njohuri kompjuterike:** Msc Office, Autocad,

**Eksperienca e kerkuar:** Mbi 5 vjet eksperience ne infrastrukture dhe ndertime civile.

Patente e klasit B

Te jete i gatshem te punoje jashte Tiranes

Te gjithë te interesuarit, janë te lutur që të dergojnë CV nepermjet adreses së e-mailit [careers@gener2.al](mailto:careers@gener2.al) ose të plotësojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare [www.gener2.al](http://www.gener2.al) në seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit është **data 17 Korrik 2023, ora 17:00**.

\* Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

\* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrotjen e të dhënave personale”.